


REPUBLICA E SHQIPËRISË
MINISTRIA E FINANCAVE DHE EKONOMISË
AGJENCIA KOMBËTARE E PUNËSIMIT DHE AFTËSIVE
SHKOLLA MEKANIKE BUJQËSORE "HASAN D. GINA" LUSHNJË



Nr. 377 prot.

Lushnjë më 29/06.2023

Lënda: Shpallje e vendit të lire me levizje paralele

**DREJTORISË SË SHËRBIMEVE MBËSHTETËSE
DREJTORISË E MARRËDHËNIEVE ME PUBLIKUN
AGJENCISË KOMBËTARE TË PUNËSIMIT DHE AFTËSIVE**

Në zbatim të ligjit nr. 15/2019, "Për nxitjen e punësimit"; të ligjit nr. 15/2017, "Për arsimin dhe formimin profesional në Republikën e Shqipërisë"; të vendimit të Këshilli të Ministrave nr. 554, datë 31.7.2019, "Për krijimin, mënyrën e organizimit dhe të funksionimit të Agjencisë Kombëtare të punësimit dhe aftësive"; të udhëzimit nr.14, datë 27.05.2021, "Për mënyrën e organizimit dhe veprimtarinë e ofruesve publikë të arsimit dhe formimit profesional, si dhe aspektet e menaxhimit të burimeve njerëzore, përbërjes së njësisë së zhvillimit të ofruesve të arsimit dhe formimit profesional dhe zhvillimit të vazhduar profesional të personelit", Ofruesi publik i AFP-së.shkolla mekanike bujqesore "Hasan D. Gina" Lushnje,

ju njofton levizje paralele për pozicionin:

Mesimdhënes i praktikës profesionale ne drejtimin SHMT (kohe te plote)

Pozicioni

1. Kriteret e përgjithshme dhe kriteret e posaçme

Aplikanti duhet të plotësojë kriteret e përgjithshme për vend të lire si vijon:

- a) të ketë zotësi të plotë për të vepruar;
- b) të jetë në kushte shëndetësore që e lejojnë të kryejë detyrën;
- c) të mos jetë i dënuar me vendim të formës së prerë për kryerjen e veprave penale;
- d) të mos ketë ndaj tij masa disiplinore që nuk janë shuar;
- e) të demonstrojë vlera të larta të etikës, sjelljes dhe komunikimit;
- f) të demonstrojë aftësi të punës në grup dhe të motivimit.

Aplikanti duhet të plotësojë kriteret e posaçme si vijon:

- a) të ketë të paktën diplomë nga një shkollë e mesme profesionale në të njëjtën fushë me
- b) kualifikimin/kualifikimet profesionale të ofruesit të AFP-së, për të cilin po aplikon;
- c) të ketë të paktën 3 (tre) vjet përvojë pune në fushën, në të cilën ka kryer studimet;
- d) të njohë dhe të përdorë teknologjinë e informacionit.

2. Dokumentet e aplikimit

Dosja e aplikimit, e cila përmban dokumentacionin e kërkuar, sipas njoftimit të vendit të lirë, duhet të përfshijë:

- a. letërmotivimin për pozicionin;
- b. jetëshkrimin (CV-në);
- c. kartën e identitetit;
- d. diplomën;
- e. librezën e punës;
- f. çdo dokumentacion tjetër që vërteton kualifikim, trajnim, apo të tjera të përmendura në CV-ne;
- g. certifikatën ose dëshminë për nivelin e njohurive në teknologjinë e informacionit;
- h. vërtetimin e gjendjes shëndetësore;
- i. vërtetimin e gjendjes gjyqësore;
- j. vërtetimin nga punëdhënësi i fundit, që ndaj tij nuk ka marrë masa disiplinore në fuqi,
- k. të paktën një rekomandim ose vlerësim pune nga punëdhënësi të mëparshëm.

Të gjitha dokumentet duhet të jenë origjinale ose të noterizuara;

Dokumentet në gjuhë të huaj duhet të jenë të përkthyer dhe të noterizuara.

Dokumentet e aplikimit dorëzohen në protokollin e ofruesit të AFP-së, brenda datës 20.07.2023

Drejtori i shkolles

Ardjan PRIFTI

